

VENDIM
Nr. 686, datë 11.9.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 39, DATË 21.1.2026, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR
VITIN 2026, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETETËRORE, PJESË TË
SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 39, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi, për vitin 2026, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë, togfjalëshi “... gjithsej, 1067 (një mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) ...” zëvendësohet me “... gjithsej, 1071 (një mijë e shtatëdhjetë e një) ...”;

b) Në shkronjën “a”, shifra 11 bëhet 15.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama